



Kuvendi i Komunës Rahovec
Opština Štarište / Rahovec / Општина Стариште / Rahovec / Општина Стариште / Rahovec

RAHOVEC / ORAHOVAC

Njësia Nr./Br./No 01 (Kuvendi i Komunës)
Nr./Br./No 0123 Nr. i faq./Br.str./No.pg 29
Datë/Datum/Date 28.02.2023

Në mbështetje të nenit 12, paragrafi 2, shkronja (d), nenit 17 shkronja a) dhe nenit 40 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008"), nenit 5, nenit 6, paragrafi 1 pika 1.1 dhe nenit 8, paragrafi 1, pika 1.1, të Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, nenit 5, paragrafi 1, pika 1.2, nenit 6, nenit 8 dhe nenit 17, të Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës dhe nenit 10, paragrafi 1 dhe 2, pika 2.4, nenit 40, nenit 57 dhe nenit 94, të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr. 1005, të datës 29.3.2017, Kuvendi i Komunës së Rahovecit në mbledhjen e mbajtur me datë 28.02.2023 merr këtë:

V E N D I M

Për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër

1. Miratohet propozimi i Kryetarit të Komunës Nr. 02/131/23, i datës 8.2.2023 dhe merret vendimi paraprak për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës, në shfrytëzim personave fizikë dhe juridikë dhe zhvillimin e procedurave të ankandit publik për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër nga 1 (një) deri në 15 (pesëmbëdhjetë) vite.
2. Prona e paluajtshme për dhënie në shfrytëzim, e cekur në pikën 1 të këtij vendimi, është në zonën kadastrale Rahovec, në vendin e quajtur Shume- Kabilja glava, me kulturë Mal i Klasës 5, e evidentuar sipas certifikatës së pronësisë P-71510057-02240-73, në sipërfaqe të përgjithshme prej 25099m² (njëzet e pesë mijë e nëntëdhjetë e nëntë metra katror), e evidentuar sipas certifikatës së pronësisë në posedim të Komunës së Rahovecit.
3. Qëllimi i dhënies në shfrytëzim i pronës së paluajtshme të Komunës, të cekur në pikën 1 dhe 2 të këtij vendimi, është ruajtja dhe rritja e vlerës së pronës publike komunale, për zhvillimin e turizmit dhe të rekreacionit, ku rritja e aseteve ekzistuese ndihmon në rritjen e vlerës së asaj prone.
4. Afati kohor për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim, të cekur në pikën 1 dhe 2 të këtij vendimi, është afatshkurtër në periudhën prej 15 (Pesëmbëdhjetë) vite.
5. Prona e paluajtshme në fjalë nuk e ndërron titullarin juridik, pronar i saj mbetet Kuvendi Komunal i Rahovecit dhe si e tillë ajo nuk mund t'i jepet personit të tretë në shfrytëzim nga ana e shfrytëzuesit, nuk mund të tjetërsohet, nuk mund të jetë objekt i ndonjë barre tatimore apo çfarëdo ngarkese tjetër mbi këtë pronë.
6. Çmimi fillestar i pronës komunale të cekur në pikën 1 dhe 2 të këtij vendimi mbi baza mujore, përcaktohet nga komisioni për zbatimin e procedurave dhe për vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës sipas vlerës së përcaktuar në Rregulloren 01 Nr. 80/20, e datës 29.6.2020 për Taksa Komunale në Komunën e Rahovecit.

7. Obligohen Drejtoria për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm, Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë dhe Zyra e Prokurimit, që në bashkëpunim me komisionin vlerësues të ofertave për dhënie e pronës së paluajtshme të Komunës në Shfrytëzim afatshkurtër dhe afatgjatë, t'i zhvillojë procedurat e ankandit publik në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës dhe Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës.
8. Obligohet Kryetari i Komunës që pas përfundimit të procedurave të ankandit publik nga Komisioni për zhvillimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale afatshkurtër dhe afatgjatë, t'i përcaktojë me kontratë të veçantë të drejtat dhe përgjegjësitë e Komunës dhe të përfituesit të pronës së dhënë në shfrytëzim.
9. Procedura për dhënie e pronës së paluajtshme në pronësi të Komunës në shfrytëzim afatshkurtër, realizohet përmes ankandit publik.
10. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81, të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale dhe nenit 8, lidhur me nenin 9, të Rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose ueb-faqen zyrtare të Komunës.

Vendimi u dërgohet:

- *Shërbimit të Kuvendit,*
- *Drejtorisë për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm,*
- *Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë,*
- *MAPL-së, dhe*
- *Arkivit.*

KUVENDI I KOMUNËS RAHOVEC

01-Nr.29/23
Me datë:28.02.2023

